


Xhemal AHMETI



Traktat

për kulturosferën shqiptare

Nëntor, 2017

Hyrje

Traktati është kondensat i një reflektimi dhe studimi të gjatë rreth dilemës *se ndodhë apo jo regresion kulturor në zonat shqiptare*.

Konkluzioni del i qartë: **Po! Regresioni është duke përparë sa më tepër zona shqiptare!**

Pasojat e tij tashmë duken gjithandej si; në arkitekturë, onomastikë, historiografi, komunikim masiv, shkolla dhe institucione të rëndësishme të shoqërisë – shkurt; alienimi vulgar dhe agresiv ka përparë gjitha domenet e socialiteteve kulturore, ekonomike të hemisferës shqipfolëse.

Shumëkush këtë zhvillim edhe mund ta quajë diversitet të harmonishëm. Nga disputi ynë mirëpo del ndryshe: Diversiteti këtu shfrytëzohet për të instaluar me çdo kusht prioritete që janë në luftë me identitetin kulturor shqiptar.

Pra nuk ndodhë si historikisht – dhe në kushte shumë më të rënda e as të krahasueshme me të tanishmet – kur fragmente të huaja kulturore integroheshin si pasuri pozitive brenda kulturës shqiptare. Sot ndodhë e kundërta; ato imponohen si konkurrencë, zëvendësuese të identitetit autentik e autokton: pra si tendencë për ta prishur një kulturë në favor të një tjetre. Këtu qëndron dhe esenca e ekspansionit, negativja, ajo që rrezikon pa të drejtë një identitet kulturor të veçantë.

Për t'i shpaluar sa më shkoqur, por edhe sa më shkurtë e qartë njohjet tona rreth dukurisë ne zgjodhëm grafikisht formën e traktatit, i cili ndahet në tri pjesë. **Pjesa e parë** përshkruan origjinën e regresit; **në pjesën e dytë** argumentojmë ç' pasojash është duke shkaktuar kjo dukuri, ndërsa **pjesa e tretë** përbëhet nga konkluzione që çojnë në një **rekomandim** për qeveritë shqiptare se si mund t'i kundërvihen këtij regresioni, i cili për bindjen tonë mund të shkaktojë probleme të rënda jo vetëm drejt tkurrjes dhe mëçorientimit së kulturosferës, por më shumë edhe të prodhojë probleme të rënda të natyrës psikologjike, humane, pra drejtë shkaktimit të një depresioni kolektiv.

Për të gjitha pohimet, statistikat dhe të dhënat e përdorura në këtë traktat autori ka mundësinë dhe përgjegjësinë, nëse i kërkohet që t'i jap referencat e nevojshme. Vërtetësia e të dhënave është në çdo kohë e garantuar.

Traktat

*mbi regresionin dhe progresin
e kulturoserës shqiptare*

1. Kulturosera shqiptare në regresion?

- 1.1. Me *kulturë* nënkuptojmë tërësinë e sendeve, vlerave, normave, arteve, ideve, aspiratave dhe institucioneve konjektive të përbashkëta të një populli në hapësira të caktuara.
- 1.2. *Kultura* është forma e jetës së një populli në një apo më shumë hapësira të caktuara.
- 1.3. Kultura në funksion të këtij traktati nënkuptohet si sistem, tërësi shpikjesh dhe kreativiteti njerëzor e një bashkësie me origjinë të caktuar, specifike etnogjenetike dhe me gjuhë të përbashkët.
- 1.4. Gjeopolitikisht kulturat janë të shkapërderdhura (diasporat) ose autoktone.
- 1.5. Kulturat autoktone me një kompaktësi të gjerë territoriale janë kombe ose konstitutorë kombesh të federalizuara. Në kontekstin negativ: të shtypura!
- 1.6. Elementët kryesorë (dhe të domosdoshëm) përbërës të një kulture konsiderohen; *Gjuha*, Korpusi i ritualeve tradicionale, varremonumentet, mitet përbashkuese konstituuese, Historia e shkruar dhe kujtesa kolektive, figurat përkujtuese të momenteve më të rëndësishme historike, Kanunet, kodet.
- 1.7. Kontinuiteti, jetëgjatësia e një kulture gjithmonë është garantuar nga gjuha.
- 1.8. Stabilitetin dhe zhvillimin më të lartë e kanë sot ato kultura, të cilat identitetin e tyre në çdo kohë e kanë riprodhuar, interpretuar qoftë duke u bazuar në vlerat e përbashkëta të grupit, etnisë e qoftë nëpërmjet politikës, shtetit që ka funksionuar si përfaqësues i vlerave të kulturës së grupit, etnisë, shoqërisë = shtetet kombëtare kulturore.
- 1.9. *Sferën* në këtë traktat e përdorim për të inkluduar edhe zonat, eksklavat dhe diasporat shqiptare, të cilat politikisht janë të ndara nga dy shtetet shqiptare, por të cilat janë pjesë e së njëjtës kulturë.

- 1.10. *Kulturosfera* si «term konstitutiv» përdoret për të mos u asociuar me ndonjë ekuivalent si ai i «frankofonisë» për arsye se zonat që popullojnë shqiptarët ende nuk përcaktohen vetëm nëpërmjet «*gjuhës së njëjtë*», por edhe autoktonisë, historisë, kompaktësisë, kontinuitetit, traditës e gjithçkaje tjetër që përcakton një komb të vetëm, sipas konceptimit të tij të sotëm kulturor.
- 1.11. Si pjesë të kësaj kulturosfere logjikshëm pasojnë: Republika e Shqipërisë, Republika e Kosovës, Shqiptarët e Maqedonisë, Shqiptarët e Malit të Zi, Shqiptarët e Serbisë dhe Shqiptarët e Greqisë (*zonat*).
- 1.12. Dy diasporat – me të drejtë autoktone por jo ashtu të legalizuara – si ajo e *arbëreshëve të Italisë dhe ajo e shqiptarëve të Turqisë* janë poashtu pjesë e kësaj kulturosfere (*eksklavat*).
- 1.13. Pjesë e kësaj kulturosfere është natyrisht edhe diaspora (*pikat*) tjetër e re dhe e shpërndarë gjithandej globit.
- 1.14. Kulturat mund të jenë *progresive* ose *regresive*.
- 1.15. *Progresive* dhe zhvilluese janë ato kur janë të hapura dhe nëpërmjet vlerave të nxjerra nga vetja ose të huazuara/absorbuar nga tjerat prodhojnë harmoninë dhe lumturinë për sa më shumë pjesëtare të saj.
- 1.16. **Me Regresion nënkuptojmë kthimin e një shoqërie apo individi në stade të mëhershme të zhvillimit apo fatit të tij.**
- 1.17. Në psikanalizë regresivë quhen ata njerëz të rritur që veprojnë sikur të ishin ende fëmijë. Në psikologjinë e masave dhe politologji të tilla konsiderohen masat që synojnë të jetojnë në modele të mesjetës, paramesjetës ose shekujve të kaluara. Sidomos modelet e dështuara ose që nga vetë kulturat autoktone konsideroheshin si armiqësore, robëruese.
- 1.18. Gjithandej ku është shfaqur kjo tendencë brenda kulturosferës shqiptare, ajo plotëson kushtet për tu kualifikuar si regresive. (shih pikën – ma vonë)
- 1.19. *Regresive* bëhen ato kultura, tek të cilat kamuflohet një diversitet që i çon drejt tëhuajësimit, mohimit të vlerave ekzistuese në favor të një kaosi ose në interes të doktrinave temporale politike e ideologjike, të cilat kanë për synim krijimin e identiteteve imagjinare që nuk përkojnë me kulturogjenezën, historinë, traditën,

- shumësinë e arteve, sistemin arsimor dhe aspiratat e proklamuarat të elitave politike të kulturës autoktone.
- 1.20. *Regresioni kulturor* ndodhë kur numri i individëve që braktisin identitetin kombëtar të lindur e trashëguar ec drejt krijimit të një shumice.
 - 1.21. Shumicat kulturoro-regresive brenda një shoqërie formohen, krijohen dhe shumohen kur sa më shumë njerëz humbin kontaktin me institucionet e shtetit dhe shoqërisë. Ai bëhet i pandalshëm, kanosës kur aspiratat e elitave politike nuk janë më kompatible me ato të sa më shumë qytetarëve, të cilët nga kjo krizë kërkojnë identifikimin në strehë tjera.

2. Zanafilla e regresionit

- 2.1. Menjëherë pas hyrjes së Republikës së Shqipërisë në sistemin pluralist, shkrimtarë me emër botuan libra ku shpaluan botëkuptimet e tyre personalisht të mos jenë të origjinës shqiptare. Përtej kësaj të drejtë të tyre personale ata shpërndanë opsionin; *shqiptarët të mos kenë gjë të përbashkët me ilirët, por të jenë turq, malazez e të llojit.*
- 2.2. Në shumicën e letrarisë shqipe u hap diskursi pro et contra historisë gjoja të falsifikuar shqiptare dhe identitetit nga rilindasët dhe sistemi i shkuar monist.
- 2.3. Njëkohësisht u hap një front diskursi *kundër* miteve identitare, nacionalizimit, patriotizmit.
- 2.4. Debati ishte njëdimensional. Mungonte mendimi i kundërt. Si i tillë debati pro identitetit shqiptar ishte i destinuar të perceptohet si demode dhe refraktar. Mediat e përkrahën mendimin e parë duke e shndërruar në *mainstream* që zgjat pjesërisht edhe sot.
- 2.5. Në trajtën e diskursit kundër etnokracisë, unionistëve diskursi i njëjtë në fillim të viteve 2000 u bart edhe në Kosovë, me intensitet dhe efekt medial shumë më të lartë.
- 2.6. Brenda Republikës së Shqipërisë u krijua një vetëpërceptim masiv që mund të kondensohet në fjalinë: „*të jesh shqiptar donë të thotë mallkim*“!
- 2.7. Brenda Republikës së Kosovës u proklamua teza se shqiptarët andej e këndej Drinit janë dy popuj krejtësisht të ndryshëm dhe që vetëm gjuhën e kanë të njëjtë.
- 2.8. Dy paradigmat qendrore në aleancë sugjeronin se ideali për bashkimin e shqiptarëve mund të prodhojë vetëm afekte në dëm të njerëzve e assesi diçka pozitive.

- 2.9. Diskursi i këtij drejtimi dikur u bartë me lehtësi në pjesët përtej shteteve shqiptare.
- 2.10. **Tëhuajësimi i parë masiv ndodhi me emigrantët në Greqi.**
- 2.11. Në fillim të viteve të 90-ta 700 mijë shqiptarë u strehuan në Greqi. Sipas statistikave zyrtare greke të vitit 2011 atje jetonin 480 mijë shqiptarë.
- 2.12. Një numër i madh i shqiptarëve që emigruan atje ndërruan kombësinë.
- 2.13. Emri i saktë i tyre nuk dihet. Spekulumet thonë të jenë ata rreth 200 mijë persona që mungojnë në statikën greke 11 vite pas emigrimit masiv.
- 2.14. Ky *deshqiptarizim* tashmë në kronikat studimore ka hyrë si i pari tëhuajësim masiv *vullnetar* i shqiptarëve në favor të një identiteti tjetër kulturor.
- 2.15. **Afekti i mendësisë së vetëmohimit identitar u përhap edhe në pjesë tjera të diasporës.**
- 2.16. Pjesa e moshës së re e emigracionit të ri shqiptar në Evropën qendrore dhe perëndimore, nga viti 2000 e këndej fshehin identitetin dhe origjinën e tyre. Ose vetëmalkoheshin para vendorëve të kenë lindur brenda kulturosferës shqiptare.
- 2.17. Gjenerata e dytë, ajo e lindura në vendet pritëse edhe sot e kësaj dite nuk donë të identifikohet me vendet e origjinës së prindërve të tyre.
- 2.18. Numri i njerëzve me këto qëndrime në perëndim është absolutisht shumicë karshi atyre që nuk riprodhojnë këtë autoaversion.

3. Rënia e institucioneve dhe kauzave

- 3.1. Me rënien e sistemeve moniste politike në kulturosferën shqiptare u shembën edhe institucionet kyçe të ruajtjes së *koherencës dhe kohezionit* shoqëror.
- 3.2. Njeriu që nuk disponon me përgjigjet ndaj pyetjeve: nga vijë unë; *kush jam unë; ku është shpella ime / kulmi ku mund të strehohem së fundi nga fatkeqësitë; cilës kulturë i përkas* – gjendet në transicion, në kërkim të një identiteti stabil.

- 3.3. Institucionet, që më së shpejti devalvuan ishin shkollat, mediat dhe sidomos ato që garantonin solidaritetin kulturor të grupeve shoqërore ndërmjet veti = *rënia e institucioneve konektive!*
- 3.4. Postulati i ideologjisë neoliberale për sa më shumë individualizëm u keqkuptua si pasaportë për leviatanizëm në disfavor të solidaritetit shoqëror.
- 3.5. Pas pavarësimit të Kosovës u shua përfundimisht edhe motori historik solidarizues i zonave shqiptare ndër vete; Diskurset e përshkruara më lartë shpallën kauzat patriotike të panevojshme.
- 3.6. Njeriu shqiptar, i rritur e formuar historikisht gjithmonë në presionin e kauzës kombëtare ose luftës për shprehje, veprim dhe vetërealizim të lirë u gjend përballë pyetjes: me ç' kuptim duhet ta mbush qenien time të përditshme praktike; cili është ideali im; cili qëllimi im?
- 3.7. Në mungesë të institucioneve shoqërore, ose për shkak të mos operimit të tyre, në mungesë të punës dhe mundësisë për vetërealizim shumica e njerëzve u hutuan, çorientuan.
- 3.8. Ata që ikën kërkuan të konstruktojnë kuptimin e jetës brenda kulturave tjera.
- 3.9. Ata që mbetën brenda dolën tregut të doktrinaeve, institucioneve të vetme funksionale që sugjerorin të ofrojnë përveç socialitetit edhe kuptimin e qenies në këtë botë dhe jetë.
- 3.10. Shumica e doktrinaeve që vërshuan nga jashtë sugjeroheshin si zëvendësuese adekuate të boshatisë që lanë kauzat kombëtare, madje edhe me frekuenca drejt përtejesisë. Ato dispononin sidomos me kushte për të ofruar ndihmë sociale dhe financa, nëpërmjet të cilave lehtësonin shtrirjen dhe ndikimin e tyre.
- 3.11. Ndërsa idealet sistemore, të demokracisë pluraliste, rrugës europiane mbeten në kompetencë të institucioneve që nuk funksionin.
- 3.12. Të parat organizata që bënë oferta praktike dhe metafizike ishin ato evangjelistët, karizamtiket dhe plotë sekte radikale brenda llojit.
- 3.13. Të fundit dështuan shumë shpejtë.
- 3.14. Më efektive në këtë drejtim dolën organizatat që erdhën nga bota islame, kryesisht nga *Turqia, Katari, Arabia Saudite, Irani* dhe vende tjera të kësaj gjeozone.

4. Ofertat nga jashtë dhe depërtimi

- 4.1. **Organizatave e huaja ndërtimin e institucioneve dhe rekrutimin e njerëzve e bënë kryesisht nëpërmjet religjioneve dhe bamirësisë së arsyetuar nga të njëjtat. Në thelb mirëpo janë pan-nacionaliste ngase si kusht kërkojnë tjetërsimin e identitetit kulturor.**
- 4.2. Organizata e parë që hapi shkolla, universitete, çerdhe, shtëpi botuese në mbarë kulturosferën shqiptare ishte ajo *Hizmet* - lëvizja gyleniste.
- 4.3. Në Shqipëri u ngritën 12 institute arsimore të mesme e të larta, në Maqedoni 7 dhe në Kosovë 5.
- 4.4. Për numrin e çerdheve, shkollave fillore «sekulare» dhe atyre fetare në kuadër xhamive, organizatave karitative dhe religjioze nuk ka të dhëna të sakta.
- 4.5. Nga viti 1992 e këndeje janë shpërndarë qindra bursa nga *Arabia Saudite* për rekrutë që donin të studionin për imamë në Riad. Studentët janë me origjinë nga të gjitha viset shqiptare.
- 4.6. Në dhjetor të vitit të njëjtë thuhet se kthehet gjenerata e 20-të e të diplomuarve atje. Grupi përbëhet prej 100 vetave të specializuar në mësimet wahabiste.
- 4.7. Njëkohësisht të diplomuar në të njëjtin drejtim kthehen vazhdimisht nga *Katari*.
- 4.8. Duke filluar nga viti 2005 edhe *Turqia* intensifikoi projektet e saja në gjithë gadishullin ballkanik. Ajo investoi në xhami, ekonomi dhe politikë duke mbështetur krijimin e partive fetare.
- 4.9. Nga Shkupi Shtëpia Botuese Logos A deri më tani ka botuar mbi 500 tituj me mbi 3 milionë ekzemplarë. 90% e titujve janë libra që hyjnë në perandorinë osmane plus islamin dhe difamojnë vlerat europiane si shkatërruese të njeriut. Financimi është bërë nga *Hizmet* në fillim, pastaj nga Katari dhe së fundi nga Turqia. Ministria e Kulturës e Maqedonisë ka financuar kryesisht botimet e autorëve vendorë.
- 4.10. Nga rrjeti i njëjtë i njerëzve me vendbanime në Tiranë, Prishtinë dhe Shkup u ndërmjetësua shitja e selisë së „*Vilajetit të Kosovës*“ në Shkup dhe nga blerësit në të njëjtën kohë – me ndërmjetësimin dhe mbështetjen e shtetit maqedonas – u formua Fondacioni Panislamik FOCIC me qendër në Shkup.
- 4.11. Rrjetit rreth kësaj organizate u takojnë pjesa më e madhe e mediave digjitale në Maqedoni dhe një TV. Në Kosovë kanë depërtuar gjithandëj. Pothuaj nuk ka media ku ithtarë të këtyre rrymave nuk mbajnë poste kyçe (si redaktorë, kryeredaktorë dhe pronarë). Në

Shqipëri ndikimin e kanë vetëm në mediat që janë të domenit fetar dhe nëpër xhami të caktuara.

- 4.12. Në *Tuz dhe Ulqin të Malit të Zi* investimet më të mëdha i bëjnë *Emiratet e bashkuara, nëpërmjet organizatave të tyre OH "Zayed bin Sultan Al Nahyan", Fondacioni "Khalifa Bin Zayed Al Nahyan", si dhe Grupi "Bin Hamoodah"*, duke përdorur si qendër operimi medresenë «*Mehmet Fatihu*», kur edhe kanë ndërtuar konvikte, librari, çerdhe dhe shkolla fetare.
- 4.13. Në *Luginë të Preshevës* investimet kryesore janë *TIKA, Halkbank* dhe organizata tjera «bamiresie» nga Turqia. Investimet bëhen gjithandej në segmente si shkollat, çerdhet, xhamitë, botimet, partitë dhe mediat.
- 4.14. Në *Kosovë* ndërkohë investori kryesor sidomos i partive, mediave, shkollave fillore dhe çerdheve, xhamive dhe vetë BIK-ut ka mbetur Diyaneti dhe TIKA turke.
- 4.15. Botëkuptimet e kësaj kategorie organizatash sot propagandohen nëpër xhami, shkolla, media, organizata bamiresie, nëpërmjet librave, partive politike dhe nëpërmjet institucioneve tjera të shtetit sekular.

7

5. Harta dhe efekti faktik i regresionit

- 5.1. **Rajonet më të prekura nga tjetërsimi në dukje, shprehje, simbolikën konektive shoqërore, riprodhimin e kujtesës, traditës, mitologemave ashqiptare, sociolektit në favor të identiteteve si ai saudit dhe turk janë *Shkupi, Kumanova, Gostivari, fshatrat të caktuara Pollogut; Gjilani, Mitrovica, Kaçaniku, fshatra të Gjakovës; Tuzi me fshatrat myslimane dhe Ulqini.***
- 5.2. Rreth 600 familje shqiptare të Malit të Zi, në rajonet e lartpërmendura spekulohet tashmë të jenë deklaruar zyrtarisht si «myslimanë etnikë».
- 5.3. Nga viti 2009 e këndej rreth 1300 familje shqiptare në **Maqedoni** kanë modifikuar ose ndryshuar emrat dhe mbiemrat e tyre plotësisht në arab e turk. Parashtesat si *Ibn/Abu/Al/Abd dhe Ali* dhe heqja e *i/a-së* (shqipërimin) janë më të shpeshtat.

- 5.4. Shumica e fëmijëve pagëzohen me emrat e kalifëve sunitë të almohadëve, umajadëve dhe fatimidëve.
- 5.5. Pas ripagëzimeve u përhap veshja e femrave kryesisht me burka, niqab dhe kador. Aktivistet publike të kësaj kategorie përdorin kryesisht mbulesat e tipit al-mira dhe hixhab.
- 5.6. Shumica absolute e foshnjoreve funksionale në vendbanimet shqiptare të Maqedonisë janë në pronë të organizatave fetare arabe ose turke, të cilat planprogramet i zhvillojnë konform qendrave në fjalë: fëmijët vishen me shami, burka, niqab brenda hapësirave të këtyre institucioneve (mejtepeve).
- 5.7. Të njëjtat rituale, veshje dhe programe vlejné në shumicën e xhamive të Bashkësisë Islame.
- 5.8. Shumica shkollave sekulare, shtetërore lejojnë ushtrimin e namazit brenda tyre ose lejojnë ndërprerjen e mësimin për çdo kohë faljeje nëpër xhamitë e afërta.
- 5.9. Në 7 vitet e fundit në shumicën e këtyre vendbanimeve nuk festohen më festat me karakter kombëtar, kulturor, por vetëm Bajramet, festat turke dhe sunite si dhe kuizeve të diturisë islame që mbahen të hapura, në sheshet e katundeve.
- 5.10. Si përfaqësuese politike e kësaj kategorie ka dalë në skenë organizata «Besa» në Maqedoni.
- 5.11. Nga fshatrat përreth Tuzit të **Malit të ZI** së fundi është e regjistruar e njëjta dukuri e «boshnjakëzimit ose turqizimit», duke u deklaruar si myslimanë etnikë e jo më si shqiptarë. Përveç arabizimit të emrave këtu vërehet edhe prapashtesa e *viç*-it që konsiderohet si simbolikë përkatësie boshnjake.
- 5.12. Veçanërisht numri i femrave që vazhdojnë shkollim sekular ka rënë totalisht. Ato që nuk mbyllen shtëpive vazhdojnë mësimet në medresetë dhe «mejtepeve» të organizuara nga organizatat arabe ose turke.
- 5.13. Nga statistikat zyrtare nuk mësohet dot se sa është aktualisht numri i familjeve ende të mbetura si shqiptare.
- 5.14. Tendenca e njëjtë është regjistruar në *Ulqin* dhe rrethinë: Deri më tani rreth 600 persona e familje kanë ndryshuar, respektivisht tjetërsuar identitetin e tyre nga ai shqiptar në turk ose boshnjak.
- 5.15. Në **Serbinë jugore**, të njohur si *Lugina* me qytetet Preshevë, Bujanovc dhe Medvegjë fëmijët kryejnë namazin nëpër klasë të shkollave sekulare. Për këtë tashmë janë publikuar dhjetëra fotografi dhe ka pasur

- dokumentare serbe, lavdëruese dhe mbështetëse të dukurisë nga ana e shtetit – në formën pro diversitetit dhe lirisë së religjioneve.
- 5.16. Përkundër investimeve të mëdha turke efekti i tyre në përditshmëri, veshje, manifestime religjioze nuk është si në Maqedoni, Ma të Zi dhe Kosovë.
- 5.17. Ka të bëjë kjo me mungesën e fakteve, ngase zona as që gjendet nën observimin e mediave shqiptare siç rajonet tjera apo është thjeshtë rezistencë e natyrshme, mbetet çështje hulumtimi të mëtutjeshëm.
- 5.18. **Në Kosovë dukuria, ofensiva e tjetërsimit është më masivja.**
- 5.19. Paralelisht me përpjekjet e organizuara të lëvizjeve kosovare për pavarësi me ndihmën e fuqive perëndimore, nga Tirana dhe Prishtina u shfaq një grup opinionistësh që botonin artikuj serik për të bindur elitat kosovare që ndihmën dhe shpëtimin e tyre ta kërkonin në Turqi dhe drejt Lindjes e jo tek Europa e krishterë dhe «*kurvë*».
- 5.20. Nga mënyra e shpalimit të kërkesave, sugjerimeve si dhe rrjetin që futën aq shpejtë në disponim shihej se këta kishin program të qartë dhe buxhet të mjaftueshëm.
- 5.21. Sa më shumë që perëndimi hapej ndaj kërkesave shqiptare aq më shumë bëhej i pashpresë ndikimi i këtij grupi. Nga viti 1998 pasoi një heshtje e kamufluar.
- 5.22. Në vitet 2007-12 nga i njëjti grup u iniciuan të ashtuquajturat Organizata të *Rinisë Myslimane* në të gjitha trojet shqiptare dhe në diasporë.
- 5.23. Këto mekanizma shërbyen si bërthama furnizuese, financuese dhe aktiviste të partive të para politike islamike si LISBA, e cila pas dështimit u nda në partiza tjera si ajo «*E drejtësisë*» dhe «*Fjala*».
- 5.24. Gjitha këto parti si shtylla të programit të proklamuar kishin tri pika të përbashkëta formale paraskenore:
- a) *Lejimi i bartjes së mbulesës në Institucione shkollore.*
 - b) *Ndërtimi i sa më shumë xhamive dhe*
 - c) *Mësimi besimit në shkolla fillore dhe të mesme.*
- 5.25. Pas dështimit të këtyre partive ithtarët e tyre u vërsulën partive tjera sekulare si LDK (Gjilan), PDK (Prizren) dhe LVV.

- 5.26. Disa ditë para vitit të ri 2017, para një podiumi me qytetarë të Mitrovicës lideri kosovar *Albin Kurti* do të thotë: «*Bile unë besoj se për kombin shqiptar, në përgjithësi, në shekullin 21, fati jonë matet me fatin e dy qyteteve, Mitrovicës dhe Shkupit. Në gjendjen në të cilat janë Mitrovica dhe Shkupi, në atë gjendje ti e kupton se në çfarë gjendje është populli yt*». Videoja, brenda vetëm disa orëve, u viralizua dhe shikua me mijëra herë. [Ekstrafetarët Shkupin dhe Mitrovicën i konsiderojnë qendra për shkak të përhapjes më të madhe të ferexhesë].
- 5.27. Në zgjedhjet e fundit nacionale (2017) shumica e klinetelës së partive fundamentaliste u përqendrua në LVV. Kjo ndodhi edhe për shkak se pjesa kryesore e kuadrove të rrjetit zanafillor të dukurisë nga Shqipëria dhe Kosova gjendet në strukturat e LVV-së dhe se kryesia e fundit popullarizoi edhe në politikë betimin e formës «*pasha kuranin, pasha musafin, pasha allahun*».
- 5.28. Ishte ky njëri nga elementët brenda masave që ndihmoi LVV të dalë e para? – Kështu analiza e shumicës së mediave.
- 5.29. Partia u sanksionua nga shumica sekulare në zgjedhjet lokale, e cila humbi vetëm disa muaj më vonë primatin e të qenurit më e madhja e vendit.
- 5.30. Fakt është se në LVV, njerëzit tashmë që operojnë nga kjo mendësi e radikalizuar islamike, janë në numër të madh.
- 5.31. Përtej partive vektorët e kësaj kategorie i has si profesorë universitetesh, redaktorë mediash, si pedagog në shkolla fillore, çerdhe, i takon si këshilltarë presidentësh e kryeministrash dhe gjithandej. Të njëjtët kanë krijuar zona të tyre brenda universiteteve dhe bibliotekave, në FSK. Në Polici janë improvizuar kënde ku zhvillohet namazi 5 herë në ditë.
- 5.32. Shumica e radikalëve në Kosovë janë të orientimit panturk.
- 5.33. Intensiteti i perceptimit dhe i manifestimit të këtyre forcave është i formës valore. Kryesisht ato aktivizohen saherë kanë përshtypjen se ndodhë ndonjë «*ekses diskriminues*» apo triumf për ti ripozicionuar në opinion. Nga këto «shpërthime» mund të lexohet qartë se si është gjendja e tyre nga koha në kohë: humbëse apo progresive, shumuese, mështrirëse edhe zonave ku më parë nuk ishin e të ngjashme.

- 5.34. Aktualisht këto rryma ato janë në trend zgjerimi – jo më në formë frontale dhe plotë zhurmë, por më të sofistikuar duke përparë «*kalatë nga brenda*».

6. Ideologjitë /Rrymat

- 6.1. **Drejtimi ideologjik** i grupeve që përhapin format e islamit radikal varret nga financuesi dhe doktrina që i sponsorizon. Prandaj edhe vetë brenda një rrjeti të përveçëm nga koha në kohë herë kemi përfaqësim të ideologjive të ndryshme që lëvizin nga panturqizmi gylenist, aktualisht erdoganesk e deri tek salafizmi agresiv. Gjersa në Maqedoni ka depërtuar thellë dhe dominon doktrina post – *Nurculuk* e Said Nursit, respektivisht *gylenizmi* si ideologji e modifikuar, në Shqipëri është më i fortë ideologjikisht *wahabizmi/salafizmi* ngase operon më shumë nga xhamitë dhe jo edhe nëpërmjet segmenteve të shtetit dhe shoqërisë civile si në Kosovë dhe Maqedoni.
- 6.2. Me *fundamentalizëm* nënkuptohet këtu ai qëndrim religjioz, i cili donë ta rindërtojë botën në bazë të urtekstit të librit të tij të shenjtë. Në këtë rast të versionit të Kur'anit.
- 6.3. Si mostra krahasuese se një ide e tillë nuk është utopi por praktike dhe e mundshme, fundamentalistët përdorin qeverisjen e *kalifëve* pas vdekjes së profetit të tyre; shtetet që sundohen në emër të *Sharia's* (= kthimi tek burimi) siç janë Arabia Saudite, Mauretani, Sudan, Katar dhe Turqia në rrugë e sipër.
- 6.4. Përveç teksteve kuranore dhe veprimeve të profetit si ekuivalente teorike thirren në asistencë edhe doktrina etateske e Vatikanit, «*Cite de Dieu*» e Leibniz-it dhe «*Civitas Dei*» e Augustinit.
- 6.5. *Wahabizmi* është rryma puriste politiko-tradicionale saudite, e shkollës „juridike“ hanbalite. Ithtarët e wahabizmit vetëquhen *Salafyya* (=salafizmi). Kjo rrymë përveç botës jomyslimane lufton edhe çdo rrymë brenda islamit që nuk është sunite; shiitët, kalāmin, sufizmin, alevizmin, panturqizmin nursiak, mistikët dhe gjitha grupet tjera.
- 6.6. Me *Gylenizëm* nënkuptohet ringjallja e neosmanizmit nëpërmjet islamit tradicional anadollak; shfrytëzimi i nacionalizmit modern turk kundër dominimeve perso-arabe në favor të një islami panturk. Realizimi i idesë

- finale është instalimi i *Sheriatit* të tipit osman, si forma e vetme e qeverisjes me popuj. Udhë deri tek realizimi i këtij synimi është më perfid nga ajo arabja: Lufta deri në fitore nuk duhet të bëhet duke luftuar tregun e lirë, dijen sekulare, demokracinë, nacionalizmat por duke i mjeshtëruar ato deri në atë pikë për t'i shkatërruar nëpërmjet defekteve që kanë (mosekzistenca e sistemit të përsosur), ngase nuk janë hyjnore.
- 6.7. Të njëjtën ideologji e përfaqëson edhe kryetari i Turqisë *Recep Tayyep Erdogan* (i formuar ideologjikisht nga Gyleni). Konflikti me ish mësuesin e tij qëndron tek momenti i hyrjes në procesin konkret të instalimit të Sheriatit. Gylen është i bindur se nuk është koha. *Erdoganistët* besojnë se presidenti aktual është i thirrur nga Zoti ta realizojë këtë ideal që e paska nis më 15 vjet më herët. [Recep Tayyep Erdogan, 2003: «Demokracia është si një autostradë, të cilën njeriu e braktis kur mbërrin në cak»]
- 6.8. **Qëllimi final si i wahabizmit (salafizmit) ashtu edhe i gylenizmit (si dy ideologji funksionale në kulturosferën shqiptare) është instalimi i sheriatit gjithandej ku jetojnë myslimanët. Metodrat dhe nacionalizmat bëjnë dallimin: menjëherë apo të pritët, islam pan-arab, apo islam-osman!**
- 6.9. Armiku i përbashkët i gjitha rrymave fundamentaliste islame është *shtetit sekular!*
- 6.10. Me *sekularizëm* në nënkuptojmë të vetmin sistem aktual që mundëson sociodiversitetin, koekzistencën e shumëve brenda një hapësire. Ai shërben si preventivë për ruajtjen e paqes shoqërore sidomos në ato hapësira të cilat përbrenda kanë ideologji e subidentitete me synime primati mbi tjerët dhe që implikueshëm rezultojnë veprime kundër harmonisë dhe bashkëjetesës së barabartë të të gjithëve. Në nuk nënkuptojmë sekularizmin vetëm brenda postulatit i të qenurit proces mental i ndarjes së shtetit nga religjioni, por më shumë, pra si model të vetëm qeverisjeje që është më i drejtë dhe nuk priorizon interesat e një grupi të caktuar.

7. Rreziqet / nacionalizmi/ identiteti/ sekulariteti

- 7.1. **Sheriati, botëkuptimet si ai wahabist/salafist, gylenist kanosin kulturosferën shqiptare në dy dimensione kryesore:** a) *Janë kundër përcaktimit të shoqërive shqiptare për demokraci pluraliste, shtete sekulare dhe barazi sociale dhe b) janë kundër identitetit kulturor shqiptar si histori dhe si aktualitet.*
- 7.2. Për shumicën e myslimanëve aktiv dhe deri fundamental shteti sekular është një konstrukt i tmerrshëm që duhet shporrur.
- 7.3. Për çdo besimtar aktiv vlen parimi: «islâm dîn va daula» [*Islami është religjion dhe shtet*]. Sipas doktrinave lartë shteti nuk duhet të jetë i ndarë nga feja.
- 7.4. «*Râshidûn*»-i, shteti ideal është i mundshëm vetëm me Sharian dhe Kalifin. Si në kohën e katër «kalifëve të drejtë».
- 7.5. Demokracia është **Demonokraci**, ngase sovranitetin ia delegon njerëzve e jo Perëndisë.
- 7.6. Jo vetëm doktrinën e lartpërmendura por edhe «**Organizata e Konferencës Islamike**» refuzon implementimin e «*Kartës së OKB për të Drejtat dhe liritë e Njeriut*» [1948]. E njëjta ka hartuar një të veten të quajtur «*Deklarata e Kairos mbi të Drejtat e Njeriut*» [1981/1990]. Deklarata që bazohet në: «*Shariatit islamik është i vetmi burim për të shtruar dhe interpretuar çdo nen të kësaj deklaratë*» [Neni 25 (1990) dhe Neni 24 (1981)].
- 7.7. Veçanërisht në këto pika Deklarata e Kairos bie në kundërshtim total me atë të OKB-së:
1. *Islami është religjioni i vetëm i vërtetë dhe qëndron mbi gjithë të tjerët*
 2. *Shtypet liria e mendimit*
 3. *Si liria negative ashtu edhe ajo pozitive në besime përtej islamit ndalohet rreptësisht.*
 4. *Minoritetet religjioze konsiderohen të rendit të dytë*
 5. *Nuk lejohet misionarizmi i çdo lloji përveç atij islamit*
 6. *Nuk garantohet e drejtë në jetë dhe palëndueshmëri [përkundrazi]*
 7. *Barazia ndërgjinore është e parandaluar.*
 8. *Vazhdon pabarazia gjinore në disfavor të femrës.*
 9. *Nuk janë në asnjë formë të garantuar të drejtat dhe mbrojtja e fëmijëve.*
 10. *Myslimanët mund të martojnë vetëm myslimanë dhe të drejtimit.*

- 7.8. Islami i botëkuptimit *wahabist/salafist* dënon hyjnizimin apo respektimin e njerëzve që nuk kanë luftuar për fenë. Të tillët konsiderohen ata që s'kanë qenë kalifë, d.m.th. mitet nacionale, kulturore e identitare që nuk përmbajnë në vete sakrificën, martirizimin për fé.
- 7.9. Islami i botëkuptimeve *anadollake, gylensite, nursiane* si kalifë i konsideron edhe sulltanët osmanë. Madje si vijë e vetme *postmohamediane*, ngase sipas tyre kalifët persë e arabë kanë devijuar që me hapjen e luftës ndërmjet dy taborëve; sunitë dhe shiitë.

8. Metodatat e (de)konstruksionit, regresionit dhe denacionalizimit.

- 8.1. Shumica e literaturës së botuar dhe propagandës që përhapen nga xhamitë dhe organizatat politikoreligjioze kishin dhe kanë për synim:
- a. Përhapjen e emrave me domethënie arabe dhe turke.
 - b. Shpopullimi i kujtesës nga mitet shqiptare që nga *Skënderbeu* e deri tek pjesëtarët e *Kongresit të Alfabetit të Manastirit*.
 - c. Ripopullimi i tyre me profetë, kalifë dhe sulltanë.
 - d. Rimodifikimi i letërsisë dhe arteve shqiptare, duke priorizuar emrat myslimanë në disfavor të atyre të religjioneve tjera.
 - e. Riinterpretimi i historisë në favor të «vasalëve pozitivë» të tipit të Hamza Beut, Esat Pashë Toptanit, Haxhi Qamilit dhe të kategorisë.
 - f. Demonizimi i *Shpalljes së Pavarësisë së Shqipërisë* si akt tradhtie ndaj osmanëve dhe islamit ose edhe shqiptarëve jashtë Republikës së Shqipërisë.
 - g. Zëvendësimi i mnemotopeve si *Iliria, Arbëria, Dardania, Rilindja Kombëtare me Perandorinë Osmane, Vilajetet*, elitat shërbyese në to për të finalizuar **tezën e konstituimit identitar nga osmanët nëpërmjet islamit**.
 - h. Proklamimi i mënyrës së jetesës në kohën osmane si adekuate dhe burimore: veshja, mbulesa, kodet e përshëndetjes.
 - i. Sforcimi i kodeve të komunikimit të përditshëm dhe avancimin e tij deri në sociolekt që nesër ta dominojë gjuhën shqiptare = me asistencën e turqizmave dhe arabizmave.

- j.* Spostimin e orientimit politik nga oksidenti në orient.
- 8.2. Doktrinat fundamentaliste aty ku kanë depërtuar kanë monopolizuar individin me identitet shqiptar në të katër dimensionet kryesore të qenies së tij, duke ia shpjeguar *natyrën, shoqërinë, metafizikën dhe individuacionin* sipas modelit kuranor të shekullit 7.
- a.* *Natyra* - Bota është kështu siç është jo si thotë shkencën, porse gjithçka është e paradeterminuar nga Zoti. Kështu është edhe me ndjenjat, mendjen, veprimet dhe refleksët tona. Shpjegimet tjera katapultohen si blasfemi dhe injorancë.
- b.* *Shoqëria* – çdo festë, përbashkim, kujtim apo munerizëm që bëhet i pamotivuar nga ideologjia religjioze gjykohet dhe refuzohet si blasfemi që duhet ndaluar. Jo normat tradicionale kulturore, ligjet dhe rregullat e preferuara nga moda në fuqi duhet të ndiqen por ato udhëzime siç i shpërndajnë nëpërmjet masmediave udhëheqësit fetarë.
- c.* *Metafizika* – gjitha enigmat e natyrës së njeriut dhe kozmosit duhet kërkuar brenda librave të shenjtë e jo shkencave, të cilat janë prodhim i demonëve. Të fundit duhet të luftohen për t'i përjashtuar nga sistemi arsimor dhe diskursi publik.
- d.* *Individuimi* – i njeriut, pavarësisht gjuhës, familjes, shoqërisë, kushtetutës, ligjeve dhe arsimit duhet të ndodhë si imitat i të nënshtruarve të kalifëve arabë dhe osmanë – në gjuhën, sistemin kulturor e religjioz të tyre.

9. Konkluzione

- 9.1. Regresioni në kuptimin siç e shtruan në pikën 1, 16-21 të këtij traktati është në zgjerim i sipër.
- 9.2. Varësisht nga reagimet ai është i valë-valshëm në intensitetin e tij.
- 9.3. Qendrat, nga menaxhohet përhapja e regresionit veprojnë brenda kulturosferës shqiptare e kryesisht jashtë territorit të dy shteteve aktuale shqiptare.
- 9.4. Synimi i këtij regresioni parasëgjithash është thyerja e miteve kombëtare, kulturore dhe etnike shqiptare dhe zëvendësimi i tyre me kalifatët e islamit.

- 9.5. Procesi nis që nga emërimi i foshnjave e deri tek tendenca për të pushtuar institucionet sekulare të shtetit. Në Kosovë dhe Shqipëri tashmë janë evidentuar plotë tekste shkollore të sajuara në këtë frymë. Pa i llogaritur këtu shkollat e shumta private, çerdhet dhe OJQ-të.
- 9.6. Për shtetet si Serbia, Maqedonia, Greqia, Mali i Zi ky regresion duket të jetë jo vetëm i mirëseardhur. Përkundrazi Serbia dhe Maqedonia asistojnë, ndihmojnë haptazi këto rryma e ndikime.
- 9.7. Shtetet shqiptare reagojnë kundër këtyre tendencave o shumë vonë o fare; atëherë kur regresioni ka përparë pjesë të mëdha të shoqërisë. Dhe ndodhë edhe për dy arsye kryesore:
 - a. Bazat e përhapjes janë të strehuara atje ku shtetet shqiptare nuk kanë shtrirje ligjore e as ndikim.
 - b. Mungojnë strategjitë *kulturosfrike* se si të veprohet karshi sulmeve të këtilla ekspansioniste qofshin ato edhe ndryshe nga këto që kanë si qëllim tjetërsimin kulturor e identitar të shqiptarëve dhe të cilat karshi tjerave (Rusia dhe tjerët) janë madje të përballueshme edhe me pak angazhim të shteteve.
 - c. Angazhimi i shteteve shqiptare nuk duhet të interpretohet si tendencë e dy qeverive shqiptare për të futur në përdorim ndonjë strategji të bashkimit kombëtar politik.

10. Propozim

Qeveria e Republikës së Shqipërisë dhe ajo e Republikës së Kosovës duhet ta kenë një strategji të përbashkët për përbashje me regresione të natyrës që sponsorizohen jo për t'i ndihmuar shoqëritë shqiptare në demokratizim, përparim e progres, por për t'i shpartalluar ato në favor të panacionalizmave të ndryshëm.

Duke u bazuar në rezultatet e këtij hulumtimi dhe gjendjet në sfera e zona të ndryshme të kulturosfërës shqiptare, qeveritë shqiptare u nevojiten masa konkrete për të parandaluar shpopullimin e kujtesës, përdhosjen e gjuhës dhe falsifikimin e historisë, pra të gjitha këtyre elementeve identitetbërëse, të cilat garantojnë koherencën, kohezionin, mbijetimin e kulturës shqiptare që në shekujt e hershëm e deri sot. Si njëri nga masat e rëndësishme koordinuese dhe motorike kundër këtij regresioni mund të shërbejë

ideja e krijimit të një **Instituti të Kulturosferës shqiptare!** Për ç'insituti është fjala?

INSTITUTI I KULTUROSFERËS SHQIPTARE (IKSH)

(Skica minimale e një ideje)

Qeveria apo Presidenca e Republikës së Shqipërisë në bazë të nenit 8, 1-3 të Kushtetutës së saj dhe Qeveria apo Presidenca e Republikës së Kosovës në bazë të nenit themelojnë Institutin e Kulturosferës Shqiptare – IKSH.

1. QËLLIMI DHE PËRFSHIRJA

- a) Instituti është apolitik dhe nuk do të përzihet në politikat e brendshme të shteteve ku banojnë a jetojnë shqiptarët.
- b) Qëllimi i dy shteteve është që të krijojnë një mekanizëm konkret, i cili nëpërmjet projekteve të ndryshme do të ndihmojë bashkatdhetarët jashtë territorit politik të dy vendeve që të ruajnë e zhvillojnë kulturën, identitetin, trashëgiminë, të drejtat dhe liritë e tyre.
- c) Si *zona autoktone* të kulturosferës shqiptare konsiderohen: Republika e Shqipërisë, Republika e Kosovës, Shqiptarët e Maqedonisë, Shqiptarët e Malit të Zi, Shqiptarët e Luginës, Shqiptarët e Greqisë. Si *eksklava* konsiderohen dy sferat pothuaj me të drejtë autoktone por jo ashtu të legalizuara siç janë ajo e **arbëreshëve të Italisë dhe ajo e shqiptarëve të Turqisë**, të cilat janë poashtu pjesë integrale të kësaj kultursofere. Kësaj sfere i përkon natyrisht edhe diaspora (pikat) shqiptare e shpërndarë gjithandej globit. Si pasojë e kësaj kemi një kulturosferë 6+2+1.

2. SELIA DHE FINANCAT

- a) Instituti do ta ketë logon e vetë me karakter gjithëpërfshirës të zonave në fjalë.
- b) Selia qendrore e IKSH- edhe për shkaqe kushtetutare e ligjshmërie – do të jetë në Republikën e Shqipërisë.
- c) Në çdo zonë, eksklavë dhe mërgatë do të ketë një zyrë/seli të IKSH-së.
- d) Financimi i Institutit do të bëhet proporcionalisht nga të gjithë pjesëmarrësit: qeveritë, partitë, shoqatat, grupet. Aty ku një gjë e tillë është e pamundshme solidarizohen tjerët.

3. HIERARKIA DHE ORGANIZIMI

a) Këshilli drejtues përbëhet nga dy kryeministrat, presidentët (për shkak të fuqisë ekzekutive e jo kryesisht ceremoniale) dhe nga 1 përfaqësues i zonave, eksklavave dhe pikave të kulturosferës shqiptare.

b) Instituti do të udhëhiqet profesionalisht nga një drejtor gjeneral i caktuar me shumicën e votave të Këshillit drejtues.

c) Struktura operative e Institutit mund të ishte kjo – gjithmonë nisur nga aspekti kulturosferik:

- Zyra e projekteve kulturore

Shembull: Organizimi i fetave të përbashkëta, pjesëmarrjeve ne tribuna globale e të llojit.

- Zyra e projekteve të komunikimit masiv

Shembull: një media kulturosferike 6+ si 3sat gjermanofonik, e cila do të absorbonte emisionet objektive të TV-ve shtetërore e private në një të vetme për mbarë kulturosferën.

- Zyra e projekteve ekonomike

Shembull: Në këtë plan tashmë ekzistojnë projekte që mund të integrohen e zhvillohen matej.

- Zyra e projekteve shkencore

Projekte të përbashkëta si konkurruese në BE e gjithandej. Organizimi i simpoziumeve të përbashkëta me karakter universal e nacional.

- Zyra e projekteve shkollore

Lobimi tek qeveritë dhe shtetet tjera për krijimin e një curricule të përbashkët arsimore në baza të gjuhës dhe kulturës aty ku është e mundshme si Gjuha, Historia dhe aspekte tjera kulturologjike.

- Zyra e botimeve dhe përkthimit

Krijimi i një SHB-je kulturosferike që distribuon prodhimet intelektuale shqiptare jo vetëm brenda kulturosferës por edhe përtej në tregun ndërkombëtar.

- Zyra e riorganizimit infrastrukturor të institucioneve kulturore.

Shembull: Pse dy akademi shkencore ku mungojnë kapacitetet qoftë edhe për një. Le të jetë një me selinë në Prishtinë e me përfaqësi edhe në Tiranë. Pse dy Institute Albanologjike kur as njëra nuk vyen, le të jetë një me seli në Tiranë apo Shkup...e në këtë formë fryme...

[Dhe të llojit sipas kushteve dhe nevojave]*

d) Zyrat përfaqësuese të institutit do të ketë siç u potencua edhe në çdo sferë, zonë a pikë. Ato mirëpo nuk do të jenë për nga volumi strukturor i njëjtte si instituti, por një zyrë me përgjegjës për çdo segmente – zyrë të institutit.

[...]

**E bëme këtë skelet minimal të idesë, brenda traktatit, ngase kemi parasysh se qeveritë shqiptare disponojnë me ekspertë që do ta sajorin statutin konkret dhe programin e këtij propozimi – në rast se ideja u duket e vyeshme.*

Bernë, Tetor 2017.